


Kujdes: Makinat qe kthehen djathtas

Shoferët që kthehen në të djathtë mund të mos i shohin çiklistat. E rëndësishme: Edhe nëse keni të drejte kalimi, kalo vetëm nëse shoferi ju shikon, ne të kundërt, prisni.



Nëse doni të ktheheni në një kthesë:

Gjithmonë sinjalizoni me dorë (krahu zgjatet në drejtimin që do të ktheheni). Para se të ktheheni, kontrolloni përreth (edhe mbrapa jush) dhe **trego kujdes** nga makinat dhe njerëzit në ecje. Nëse ktheheni majtas, kujdes nga trafiku që vjen nga **drejtimi i kundërt**.

Parakalimi

Kur parakaloni çiklista të tjerë, sigurohuni të keni hapësirë dhe nevojshme për ju dhe ciklistin që po parakaloni. Përpara se të parakaloni **përdorni zilen** e biçikletës për të njoftuar pedalesin tjetër që jeni në të majtë dhe po kërkon parakalim.

Ku mund të ngas biçikletën time?

Në rrugë (me makina)

Nëse ju **nuk shihni** një tabelë ku indikohet korsa për biçikleta atëherë ju jeni të lejuar të pedalonit në rrugë, gjithmonë **në krahun e djathtë të saj**.

Informacion mbi gjobat ndaj thyerjes së rregullave të trafikut

Çiklistat që nuk respektojnë rregullat e qarkullimit rrugor mund të gjobiten me gjoba shumë të mëdha edhe në raste kur nuk ndodhin aksidente.

Informacion i përgjithshëm

Në Gjermani të gjitha makinat, përfshi biçikletat, duhet të **përdorin kahun e duhur** të rrugës.

Është e rekomanduar të përdoret **kokorja e biçikletave**. Ajo ju mbron kokën në rast goditjeje.


Tregoni kujdes **ndaj të tjerëve** që udhëtojnë në rrugë ose në korsinë tuaj.

Jini i gatshëm për të ndaluar: Shikoni për makina që kalojnë në kryqëzim me rrugën tuaj ose që dalin nga vendparkimet.

Kujdes: shoferat e kamionëve kryesisht nuk i shohin çiklistët ndaj **qendroni pas tyre**.

Mbi ADFC

Klubi i Përgjithshëm Gjerman i Biçikletave, sh. e regj. (Allgemeine Deutsche Fahrrad-Club e.V. - ADFC) është me mbi 155.000 anëtarët e tij, jo vetëm në Gjermani, por edhe në mbarë botën, përfaqësuesi më i madh i interesave të çiklisteve dhe çiklistëve. Ai ju këshillon mbi të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me biçikletën: në aspektin juridik, teknik apo në atë turistik. Në aspektin politik ADFC angazhohet në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar për nxitjen dhe promovimin e vazhdueshëm të qarkullimit me biçikletë.



Copyright by



Allgemeiner Deutscher Fahrrad-Club (ADFC)
Kreisverband München e.V., AG Asyl
Platenstr. 4, 80336 München
asyl@adfc-muenchen.de

In Kooperation mit dem ADFC Mönchengladbach · www.adfc-mg.de
unterstützt von der Verkehrswacht Mönchengladbach e.V.



Udhëtoni të sigurt me biçikletë

Rregulloret trafikut për çiklistët

Version Albanisch



Shenja të rëndësishme të trafikut

Vendkalimi për biçikleta (i detyrueshëm!)

Çiklistet **duhet** të pedalojnë në drejtimin e indikatorit me këtë shenjë për biçikletë. Ata nuk lejohet të përdorin rrugën kur kjo ta-belë është prezente.



Rrugë e ndarë për kalimtarët dhe biçikletat

Rruga e kalimtarëve dhe e biçikletave janë pranë njëra -tjetrës. Biçikleta **duhet** të pedalojë vetëm në krahun e treguar nga kjo tabelë. Mos përdor rrugën e kalimtarëve madje edhe kur pedalojnë të tjerët aty. Biçikleta nuk duhet pedaluar në rrugë kur kjo shenjë është prezente.



I njëjti vendkalim për kalimtarë dhe biçikleta

Biçikleta **duhet të pedalojë** në vendkalim për biçikleta. Kur kjo tabelë është prezente rruga përdoret nga biçikleta dhe kalimtarë ndaj duhet të jeni të kujdesshem. **Nuk duhet të pedalojë** në rrugë kur kjo shenjë është prezente.



Shënim: Respektoni kalimtarët. Njoftojni ata me zile në rastet kur dëshironi të kaloni përpara

Vendkalim për kalimtarë

Zbrisni nga biçikleta dhe merrni prej dore. Ju **nuk lejoheni** të ngisni biçikletën në vendkalimin për këmbësorë nëse shihni këtë shenjë. Nëse nuk ka korsi për biçikleta ju **duhet** të përdorni rrugën (me makinat).



Përfundim: Fëmijët nga 8 deri në 10 vjeç **mund** të përdorin vendkalimin e këmbësorëve.

Zone këmbësorësh

Ndalohet pedalojë këtu. Zbrisni nga biçikleta dhe merre prej dore nëse shihni këtë shenjë.



Përfundim: Nëse kjo tabelë sho-qëron tabelën e mësipërme ju jeni të lejuar të pedalojë në **rrugën për këmbësorë** ose në zonën e tyre, **por vetëm** me shpejtësinë e ecjes së tyre. Prioritet kanë kalimtarët!



Në çfarë drejtimi mund të pedalojë?

Gjithmonë duhet të pedalojë biçikletën në drejtimin e duhur në të **gjitha** rrugët.

Nuk duhet të pedalojë në mes të trafikut!
Përfundim: Kur kjo tabelë është prezente lejohet pedalojë në të dy drejtimet e kësaj rruge.



Rrugë me një kalim

Të gjitha mjetet mund të lëvizin vetëm në drejtimin e indikatorit në këtë tabelë.

Përfundim: Kjo tabelë lejon lëvizjen në të dy drejtimet e rrugës.



Ndalim Kalimi

Ndalohet kalimi në rrugët ku shihni këtë tabelë. Ju mund të merrni prej dore biçikletën në korsinë e këmbësorëve.

Përfundim: Kjo tabelë ju lejon të pedalojë në rrugë **në të dy drejtimet** e saj, por duhet të tregoni kujdes nga makinat që lëvizin **drejt jush!**



Ndalim përdorimi i biçikletave dhe mjeteve të tjera

Ndalohet pedalojë këtu.



Ndalohen mjetet lëvizëse këtu.

Zbrisni nga biçikleta dhe merrni prej dore.



Kujdes: Të tjerët kanë të drejtën e kalimit

Makinat në drejtimin tjetër kanë **përparësi kalimi**. Nëse nuk ka tabelë përparësie në kryqëzimet e rrugëve rregullisht është: **Ata që vijnë nga e djathta kanë të drejtë kalimi** dhe mund të shkojnë të parët (prioriteti nga e djathta).



Ndalo – Të tjerët kanë të drejtën e kalimit

Ndalo dhe lejo të tjerët të kalojnë (kanë përparësi).



Dritat e Semaforit


Në shumicën e kryqëzi-meve trafiku drejtohet nga semaforët.

Kuptimi i ngjyrave

Kuqe: Ndalo dhe prit!

Jeshile: Ju mund të kaloni.

E verdhë: Tregon që semafori do të ndryshojë së shpejti nga e Kuqe në Jeshile ose nga Jeshile në të Kuqe.



Ndonjëherë korsia e kalimtarëve ka sinjalistikë speciale:

Edhe korsia e biçikletave shpesh-herë sho-qërohet me semaforë për çiklista dhe këmbësorë:



ose sinjalistikë speciale për biçikleta:

Nëse nuk ka sinjale për çiklista në korsinë e biçikletave respektoni sinjalet për këmbësorët.

Rrugë me shpejtësi të ulët (fëmijë që luajnë)

Të gjitha mjetet lëvizëse, përfshi biçikletat mund të lëvizin vetëm në shpejtësinë e ecjes në këmbë. Tregoni kujdes! Fëmijë mund të jenë duke luajtur në këto rrugë.



Vijat e bardha

Kjo tabelë tregon që këmbësorët që kalojnë aty kanë përparësi. Të gjitha mjetet lëvizëse dhe biçikletat duhet të presin.

